



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Gjykata

Numri i lëndës: 2019:247222

Datë: 10.05.2024

Numri i dokumentit: 05668090

Ac.nr.9997/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegji të përbërë nga gjyqtarët Kujtim Pasuli – kryetar i kolegjit dhe Malsor Kryeziu e Fatmir Baloku - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditëses Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (PTK), me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson i autorizuari S. Th. nga Prizreni, kundër të paditurit N.P.T. SH., nga fshati Zh., Komuna e Prizrenit, të cilën me autorizim e përfaqëson, av. R. B. nga Prizreni, për shkak të kompensimit të dëmit, vlera e kontestit 2.283.00 €, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1780/2019 të datës 07.09.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 02.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore, për të vendosur në këtë çështje juridike kontestimore.

II. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi lënda t'i dërgohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë Dhomës së Shkallës së Dytë-Departamentit për Çështje Ekonomike, si gjykatë kompetente, në pikëpamje lëndore.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, me Aktgjykimin e atakuar C.nr. 1780/2019 të datës 07.09.2021, ka vendosur:

“I. REFUZOHET në tërësi e pabazuar kërkesëpadia e paditëses Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (PTK), me seli në Prishtinë, me anë të së cilës kanë kërkuar që të “Obligohet i padituri

N.P.T.Sh.nga fshati Zhur, Komuna e Prizrenit”, që në emër të kompensimit të dëmit paditëses t’i paguajë shumën prej 2,283.00 euro, me kamatë ligjore prej 3.5 %, nga dita e paraqitjes së padisë deri në pagesën definitive dhe të obligohet i padituri me të gjitha shpenzimet e procedurës kontestimore, në lartësinë të cilën e cakton gjykata”.

II. DETYROHET paditësja PTK, që në emër të shpenzimeve procedurale, t’ia paguaj të paditurit N.P.T.Sh. shumën prej 1,327.00 euro, të gjitha këto brenda afatit 15 ditor nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.”

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë paditësja Telekom i Kosovës (PTK), për shkak të:

- shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore,
- vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike,
- aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe
- vendimi për shpenzimet procedurale, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, që të aprovohet e bazuar ankesa e paditësit të aprovohet në tërësi e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit dhe të detyrohet i padituri që t’ia paguaj paditësit shumën prej 2.283,00 €, në emër të kompensimit të dëmit, me kamatë ligjore prej 3.5 % nga dita e paraqitjes së padisë deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, ose të aprovohet e bazuar ankesa dhe aktgjykimi i goditur të prishet dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Përgjigje në ankesë nuk është parashtruar.

Pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, Gjykata e Apelit- kolegji i kësaj gjykate vlerëson se, pasi që palët në këtë procedurë paditësja dhe i padituri janë persona juridikë, atëherë për vendosje në këtë çështje juridike kontestimoe, kompetent në pikëpamje lëndore është Gjykata Komerciale-Dhoma e shkallës së dytë-Departamenti për Çështje Ekonomike, e kjo bazuar në dispozitën e nenit 13 par.1 pika 1 dhe par.2 të Ligjit për Gjykatën Komerciale.

Ligji nr. 08/L-015, për Gjykatën Komerciale parasheh që kompetente për të vendosur në këtë çështje kontestimore në bazë të nenit 10 e lidhur me nenin 13 të këtij ligji është Gjykata Komerciale, ngase sipas dispozitës së nenit 10 par.1 parashihet se “Gjykata Komerciale gjykon çështjet brenda kompetencës së saj në dhomat e shkallës së parë dhe në dhomat e shkallës së dytë. Vendimet e dhomës së shkallës së parë janë të barasvlershme me vendimet e Gjykatave Themelore, kurse vendimet e dhomës së shkallës së dytë janë të barasvlershme me vendimet e Gjykatës së Apelit”, ndërsa sipas dispozitës së nenit 13 par. 1 pika 1.1 parashihet që “Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar në dhomat e shkallës së parë dhe dhomat e shkallës së dytë dhe atë sipas pikës 1.1 kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridik publik dhe privat në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare si dhe çështjet e tjera mes tyre.”

Prandaj, mbi bazën e të dhënave si më lart, Ju dorëzojmë në kompetencë të mëtejme këtë lëndë bashkë me të gjitha shkresat e saj për të vendosur sipas ankesës, e ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm C.nr. 1780/2019 të datës 07.09.2021.

Nga të lartcekurat e në bazë të dispozitës së nenit 13 par.1 pika 1 dhe par.2 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, e lidhur me nenin 77 dhe 17 të LPP-së, si dhe nenin 29 dhe 208 të LPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.9997/2021, me datë 02.05.2024

Gjyqtari
Kujtim Pasuli